

STATUTI DHE AKKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" GAMA-AL 2014 " SHPK

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

a. Sot në Tiranë në datën 13 Janar 2023 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "GAMA-AL 2014" shpk, me vullnet shoqëritë tregtare. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "GAMA-AL 2014" shpk, formohet nga ortakët themelues:

Gëzim Musaj shtetas shqipetare, i datëlindjes 26.01.1963 lindur ne Tirane, Shqiperi, dhe banues ne Republiken e Shqiperise, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID: G3126094H

b. I cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "GAMA-AL 2014" SHPK., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

Neni 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
2. Emërtimi i Shoqërisë është: "GAMA-AL 2014." SHPK.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 3

1. Shoqëria tregëtare "GAMA-AL 2014" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tirane, Tirane Kamez KAMEZ Lagjja Nr. 11, Rruga Durrsi, Banese private Nr. 2/50.
2. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin shqiptare kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.
5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KOHËZGJATJA

Neni 4

Gëzim Musaj
[Handwritten Signature]

Faqja 1 nga 5

1. Shoqëria Tregtare "GAMA-AL 2014" SHPK., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktimë të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i shoqerise "GAMA-AL 2014" SHPK do të jetë:

-Mirembajtje godinash (punime ne ndertim), tregtim te mallrave industriale, te materialeve te ndertimit, pjese kembimi dhe servis automjetesh, sherbime profilaktike per automjetet, tregti te gomave te makinave, transport mallrash per vete dhe te trete, riparime elektromekanike, kancelari. Tregtimi i mallrave hidrosanitare, ushqimore dhe tregtia e materialeve te ndertimit dhe veglave te punes. Sherbime perkthimi te gjuges angleze dhe konsulencë juridike.

.TË DREJTAT E SHOQËRISË

Neni 6

Shoqëria tregtare "GAMA-AL 2014" SHPK., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarrur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin, sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë (njeqind mijë lekë), i cili është têrësisht kapital finanziar. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (një) kuota, me vlerë nominale 100,000 lekë (njeqind mijë lekë).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. Gëzim Musaj zotëruesh i 1 (një) kuote apo 100% të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku ka të drejtë të tjetersoje, të zmadhoje apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji. Kapitali fillestare nuk është paguar.

NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Përbërja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithësme të shoqerisë dhe në përgjithësi çdo operacion finanziar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqëria Tregetare "GAMA-AL 2014" SHPK., është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejtë të tjera materiale në perputhje me legjislacionin përkatës shqiptare.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

NENI 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti finanziar i shoqërisë do të mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.

3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakëve të saj.

NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar nuk janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato nuk janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

NENI 13

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

NENI 14

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakëve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo i zvogëlimi i tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqerise mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË

ORTAKËRIA

NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregtare "GAMA-AL 2014" SHPK., gjëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve

NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrithana të caktuar;

KREU I TRETË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Klajdi Musaj** i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëni me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë;
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkoje administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjeter që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqerinë në marrëdhëni e saj me të tretët, e në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 22

Administratori është përgjegjës individualist sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërkonhet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitet, zëvendësueshmërinë, térheqjen, shkarkimin dhe shpërbëlimin e tij zbatohet legjislacioni shqiptare në fuqi.

NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptare në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënesi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njofuar organet e Punës së Juridiksonit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

FORCAT MADHORE NENI 25

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftësi të plotësojnë detyrimet e tij për arsyen të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negativ (Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyen të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shume likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim "Shoqëri në likujdim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

BAZA LIGJORE Neni 27

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT Neni 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënavës dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe Legjislacioni shqiptare në fuqi.

NENI 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

NENI 31

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET:
Gëzim Musaj

